

KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës IV (Mjedisi)

Sesioni 1, Tema: Konventa e Aarhus-it dhe situata në Shqipëri

28 Korrik 2015

Zhvillimet aktuale

Grupi i punës vlerësoi se Shqipëria ka arritur zhvillime pozitive përsa i përket Kapitullit 27 të Raportit të Progresit në lidhje me Mjedisin, në pikëpamjen e përafrimit të legjislacionit shqiptar me parashikimet e Konventës së Aarhus-it.

I. Përafrimi i Legjislacionit

Duke qenë pjesë e kësaj konvente, Shqipëria ka miratuar ligje të cilat synojnë zbatimin e tre shtyllave kryesore të Konventës së Aarhus-it dhe përkatësisht: (i) aksesin në informacionin mjedisor; (ii) aksesin në vendim-marrjen mjedisore; (iii) aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore.

Aksesi në informacionin mjedisor rregullohet në Shqipëri në mënyrë të dyfishtë: nga ligji i posaçëm për mjedisin, përkatësisht Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" si dhe nga ligji i përgjithshëm për të drejtën e informimit në të gjitha fushat, përfshirë edhe mjedisin, përkatësisht Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në mënyrë të ngjashme aksesin në vendim-marrjen mjedisore rregullohet nga ligje të posaçme për mbrojtjen e mjedisit siç janë Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe Ligji nr. 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe aktet përkatëse nënligjore, si dhe nga ligji i përgjithshëm mbi konsultimin publik në çështjet me interes publik ku domosdoshmërisht përfshihen çështjet me impakt mjedisor, përkatësisht Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Aksesi në drejtësi për çështjet mjedisore, i konsideruar dhe i pranuar nga grupi i punës si shtylla thelbësore e Konventës së Aarhus-it pa ekzistencën e së cilës të drejtat e parashikuara nga dy shtyllat e tjera janë të pazbatueshme, rregullohet gjithashtu nga legjislacioni shqiptar me anë të legjislacionit të posaçëm për mbrojtjen e mjedisit dhe së fundmi me anë të Ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Ligji për Gjykatat Administrative i miratuar rishtazi në vitin 2012, i cili legjitimon aksesin pranë gjykatave administrative jo vetëm për personat fizik por edhe për personat juridik, siç është rasti i organizatave jo qeveritare që trajtojnë çështje mjedisore, u konsiderua një lehtësim për aksesin në drejtësi, pavarësisht vështirësive që një subjekt mund të hasë në

përmbushjen e kushteve për t'u legjitimuar t'i drejtohet gjykatës administrative për shqyrtimin e çështjeve mjedisore.

II. Zbatimi i Konventës së Aarhus-it dhe legjislacionit Shqiptar

Gjatë takimit me grupin e punës u vu në dukje se megjithëse legjislacioni shqiptar është afruar në mënyrë domethënëse me kërkesat e Konventës së Aarhus-it dhe me legjislacionin e Bashkimit Europian në këtë fushë, çështja e zbatimit të legjislacionit mbetet një nga sfidat kryesore të Shqipërisë. Në këtë aspekt Shqipëria është ende larg zbatimit të kënaqshëm të Konventës së Aarhus-it dhe standarteve Europiane në këtë fushë. Megjithatë disa nisma janë ndërmarrë nga autoritetet shtetërore për të mundësuar zbatimin e detyrimeve të Konventës së Aarhus-it dhe legjislacionit shqiptar.

Ndër nismat e ndërmarra në kuadër të së drejtës së informimit, u përmend miratimi i Programit të Transparencës, i cili konsiston në krijimin dhe mbajtjen e Regjistrimit të kërkesave të publikut për informacion mjedisor dhe përgjigjeve përkatëse që do të publikohet çdo tre muaj në portalin online, si dhe fillimi premtues i punës për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit të shkarkimeve të ndotësve.

Gjithashtu, në kuadër të Integritimit Europian të Shqipërisë dhe detyrimit të parashikuar në nenin 108 të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit ("MSA") i cili përcakton se "*Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore*" është hartuar dhe po vihet në zbatim "Plani Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për vitin 2015". Ky plan ka parashikuar ngritja e një sistemi të përshtatshëm monitorimi në përputhje me standardet europiane i cili do të ndihmojë në mbledhjen e të dhënave për mjedisin dhe informimin e shpeshtë të publikut të interesuar, gjë që synon të sjellë si rezultat përfshirjen e sa më shumë individëve dhe subjekteve në vendim-marrjen mjedisore. Si hap të parë Ministria e Mjedisit ka krijuar Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit për të gjithë komponentët e mjedisit si ajrin, ujrat, tokën, pyjet dhe biodiversitetin.

Për sa i përket çështjes së pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrjen mjedisore, u vu në dukje gjatë takimit të grupit të punës se Vendimi i Këshillit të Ministrave . 247, datë 30.04. 2014, për "*Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore*" po vihet në zbatim dhe si rrjedhojë individët apo OJF-të e angazhuara në çështjet mjedisore marrin pjesë gjatë procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ("VNM").

Grupi i Punës konsideroi si hap pozitiv faktin që me asistencën e BE-së Ministria e Mjedisit ka ngritur grupe të posaçme pune të cilët ndërmarrin iniciativa për sensibilizimin e qytetarëve lidhur me çështje ndaj të cilave ata janë gjithnjë të ndjeshëm, sikurse janë çështjet mjedisore. Gjithashtu u përmend bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Qendrës Mjedisore Rajonale, dhe Ministrisë së Drejtësisë, në nismën e informimit dhe trajnimit të

studentëve të shkollës së Magjistraturës mbi çështjet ligjore të mjedisit dhe në realizimin e paketës ligjore për krimin mjedisor, si dhe në nxitjen e vendim-marrjes së drejtpërdrejtë të opinionit publik apo organizatave të tjera.

Së fundmi, u përmend se Qendra Rajonale e Mjedisit(REC) ka mbledhur dhe përpunuar një sërë të dhënash duke marrë parasysh faktorë të tillë si niveli i informimit të qytetarëve për çështjet mjedisore, interesi për përfshirje në vendim-marrjen mjedisore, lidhja midis nivelit të arsimimit dhe marrjes përsipër të përgjegjësive në lidhje me problemet e mjedisit, etj. Bazuar në këto të dhëna REC do të publikojë në shtator Studimin mbi Perceptimin e Publikut për Mjedisin.

Probleme & Rekomandime

1. E drejta e publikut për të patur akses në informacion mjedisor

Gjatë diskutimeve në takimin e grupit të punës u vunë në dukje problemet kryesore të cilat pengojnë publikun të jetë i informuar në mënyrën e duhur në lidhje me çështjet mjedisore.

Së pari, u ngrit si problem fakti që qytetarët, shoqëria civile por edhe vetë OJF-të të cilat trajtojnë çështjet mjedisore shpesh hasin vështirësi në marrjen e disa informacioneve të ndjeshme, të cilat në përputhje me ligjin duhet të bëhen të aksesueshme për publikun nga vetë autoritetet shtetërore pa qënë nevoja që publiku të bëjë kërkesë specifike për marrjen e tyre. Këto vështirësi janë hasur p.sh në rastet kur nga OJF-të mjedisore është kërkuar njohja me VNM-të e projekteve me impakt të rëndësishëm mjedisor siç ka qënë rasti i hidrocentralit të Ashtës apo ndërtimi i rrugës Durrës-Kukës. Në raste të tjera është përdorur nga autoritetet edhe karta e sekretit shtetëror, si p.sh në rastin e kryerjes së manovrave ushtarake në jug të vendit ku ka munguar informacioni mbi impaktin mjedisor të tyre.

Një problem tjetër rezulton të jetë marrja e informacionit në kohën e duhur gjë që sjell si rrjedhojë pamundësinë e publikut për të marrë pjesë në vendimet mbi çështjet mjedisore apo për të qënë aktiv në çështjet e rëndësishme me impakt mjedisor. Në të njëjtën mënyrë është vënë në dukje edhe fakti se përdorimi i internetit si mjet i shpërndarjes së informacionit mjedisor bën të vështirë apo të pamundur shpërndarjen e këtij informacioni për një pjesë të rëndësishme të Shqipërisë, veçanërisht zonave të prapambetura rurale, ku subjektet për shkak të kushteve të tyre socio-ekonomike nuk kanë akses në internet.

Së fundmi, u theksua rëndësia e bashkëpunimit midis organeve të pushtetit qendror si Ministria e Mjedisit, dhe njësisë të pushtetit vendor të cilat janë të vendosura më pranë qytetarëve e si rrjedhojë mund dhe duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me shpërndarjen e informacionit mjedisor pranë komuniteteve të tyre. Në këtë kuadër u vu në dukje se ekzistojnë probleme në bashkëpunimin me njësitë e pushtetit vendor të cilat kanë

mangësi në dhënien e informacioneve mjedisore ndaj komunitetit të tyre. Në shumë raste njësitë e pushtetit vendor nuk e kuptojnë qartë përgjegjësinë e tyre në lidhje me dhënien e informacionit mjedisor ndaj komunitetit. U përmend si shembull procesi i riciklimit të mbetjeve në burim (për vitin 2017), për të cilin njësitë e qeverisë vendore akoma nuk u kanë shpërndarë qytetarëve të komuniteteve të tyre paketat informuese mbi mënyrën e realizimit të këtij procesi.

❖ Rekomandime

Hapi i parë i domosdoshëm për realizimin e të drejtës së publikut për të pasur akses në informacionet mjedisore është **mbledhja dhe përpunimi i informacioneve mjedisore** nga vetë autoritetet shtetërore. Shpeshherë në Shqipëri informacioni është i copëzuar dhe i shpërndarë në institucione të ndryshme gjë që vështirëson aksesin në informacion. Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit në varësi të saj, në cilësinë e organeve të pushtetit qendror që mbulojnë çështjet e mjedisit duhet të vazhdojnë të luajnë një rol parësor në mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve mjedisore. Për këtë është e nevojshme fuqimizimi i strukturave të këtyre institucioneve me anë të vënies në dispozicion të burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare. Gjithashtu edhe autoritetet e tjera shtetërore, në nivel qendror apo vendor, duhet të kenë brenda strukturave të tyre njësi të posaçme të cilat të kujdesen për mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve mjedisore me të cilat ndeshen gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre.

Hapi i dytë i domosdoshëm është shpërndarja e informacionit mjedisor të mbledhur dhe përpunuar nga autoritetet shtetërore. Për të realizuar shpërndarjen sa më të gjerë të informacionit mjedisor në mënyrë që numri më i madh i qytetarëve të kenë akses dhe dijeni për ekzistencën e këtij informacioni është i nevojshëm përdorimi i ndërthurur i të gjitha mjeteve ekzistuese të komunikimit. Për një vend me karakteristikat e Shqipërisë, publikimi i informacioneve mjedisore online nuk është i mjaftueshëm. Për këtë arsye një **fushatë informimi mjedisor** mund të kryhet duke përdorur mjetet më popullore të komunikimit në Shqipëri siç janë gazetatat por mbi të gjitha televizioni. Autoritetet Shtetërore, sidomos për çështje të rëndësishme me impakt mjedisor mund të informojnë publikun nëpërmjet mediave për ekzistencën e projekteve të ndryshme apo për nxjerren dhe publikimin e raporteve të ndryshme me interes mjedisor dhe të udhëzojnë qytetarët se cilit institucion mund t'i drejtohen për paisjen me këto informacione. Një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacioneve mjedisore mund të luhet edhe nga njësitë e qeverive vendore të cilat për shkak të pozicionimit të tyre më afër komunitetit që përfaqësojnë e kanë më të lehtë të informojnë komunitetin me anë të shpalljeve pranë bashkive, me anë të organizimit të takimeve informative, publikimit të broshurave informuese, posterave sensibilizues, etj. Duke marrë parasysh dhe Reformën e re Administrative, duhet kushtuar një rëndësi e

veçantë në përgatitjen e Bashkive për të ngritur strukturat përkatëse për informimin dhe monitorimin e detajuar të çështjeve mjedisore.

Si përfundim del qartë në dukje se është e domosdoshme heqja e barrierave reale dhe praktike të aksesit të publikut në informacionin mjedisor. Përveç mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së informacionit mjedisor nga autoritetet shtetërore është e nevojshme që publikut të mos i mohohet aksesin në informacionin mbi çështjet mjedisore me interes të lartë publik dhe kërkesat e tyre për informacion të trajtohen në mënyrë të plotë, të shpejtë dhe efikente. Për të bërë të mundur këtë strukturat ekzistuese pranë autoriteteve shtetërore të cilat trajtojnë kërkesat e publikut për çështjet mjedisore duhet të fuqizohen dhe të pajisen me burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e detyrës së tyre në mënyrë optimale.

2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendim-marrje për çështjet mjedisore

Siç u shpjegua më sipër legjislacioni shqiptar ka parashikuar të drejtën e publikut për të marrë pjesë në vendim-marrjen mjedisore. Pjesëmarrja e publikut kryhet me anë të procedurave të konsultimit apo dëgjësave me publikun e interesuar gjatë fazave të VNM-ve apo për projekte të caktuara me impakt mjedisor. Gjatë takimit të grupit të punës u vunë në dukje vështirësitë praktike dhe barrierat reale të realizimit të pjesëmarrjes së publikut në mënyrë optimale.

Së pari ka mangësi në informimin e publikut të interesuar për ekzistencën e dëgjësave apo konsultimeve publike për një projekt të caktuar. Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila kryen dëgjësat me publikun, delegon tek Agjencitë Rajonale të Mjedisit detyrën e kryerjes së dëgjësave dhe konsultimeve me publikun. Megjithë përpjekjeve maksimale, Agjencitë Rajonale të Mjedisit në përmbushjen e kësaj detyre hasin vështirësi për shkak të strukturave të limituara në burime njerëzore dhe financiare. Siç u përmend edhe në rastin e dhënies së informacionit mjedisor, edhe në rastin e dëgjësave dhe konsultimeve publike, njësitë e qeverive vendore shpeshherë nuk janë aktive në informimin e komunitetit për zhvillimin e dëgjësave dhe konsultimeve me publikun. Si rrjedhojë numri i pjesëmarrësve në dëgjësat dhe konsultimet publike është shumë i vogël.

Së dyti cilësia e dëgjësave me publikun shpesh lë për të dëshiruar. Për shkak të situatës socio-ekonomike të qytetarëve që marrin pjesë në dëgjësat me publikun ndjeshmëria e tyre ndaj aspektit mjedisor të një projekti nuk është gjithmonë maksimale. Vihet re që përveç interesimit për impaktin mjedisor të një projekti, publiku pjesëmarrës interesohet edhe për impaktet e tjera që projekti mund të sjellë në jetën e tyre si p.sh hapja e vendeve të reja të punës, zhvillimi i zonës përreth projektit etj.

❖ Rekomandime

Në mënyrë që publiku të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të informuar duhet së pari të ketë në dispozicion informacionet mbi vendin, orën dhe datën e zhvillimit të dëgjësive, projektet për të cilat do të kryehet dëgjësia dhe informacione përmbledhëse mbi impaktin mjedisor të tyre. Ky informacion i fundit duhet të jepet në mënyrë sa më të qartë dhe të kuptueshme duke pasur parasysh se publiku i interesuar nuk përbëhet nga specialistë të fushës së mjedisit dhe duhet të shpërndahet jo vetëm me mjetet e komunikimit online, apo afishimit pranë njësive bashkiake vendore, por edhe me mjetet e komunikimit masiv siç janë televizioni apo gazetat.

Autoritetet shtetërore duke respektuar edhe synimin e Konventës së Aarhus-it, për *“promuovimin e edukimit mjedisor dhe inkurajimin e ndërgjegjësimit të publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimet që ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit”*, duhet të përdorin të gjitha mjetet në dispozicion për të rritur ndjeshmërinë e qytetarëve mbi çështjet e mjedisit në përgjithësi dhe impaktin e projekteve apo politikave të caktuara në veçanti. Kjo mund të realizohet me anë të **informimit dhe konsultimit të vazhdueshëm me komunitetet e zonave rurale** në sajë të tryezave të diskutimit. Konsultime të tilla duhet të vijnë sidomos nga njësitë e qeverisjes vendore në zona të ndryshme në bashkëpunim me organet qëndrore dhe me agjencitë rajonale mjedisore. Duhet të të rritet ndjeshmëria e qytetarëve mbi çështjet me rëndësi mjedisore për komunitetin dhe të shojegohet dallimi midis interesit mjedisor dhe interesave të tjera vetjake (si psh. Mundësitë e punësimit). Rekomandohet që në raste dëgjësash publike të adresohet e targetohet grupi i duhur i interesuar për çështjen. Shembull pozitiv i dëgjësive publike në këtë aspekt janë dëgjesat e kryera në kuadër të projektit TAP.

3. E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit

Siç u vu në dukje gjatë mbledhjes së grupit të punës, e drejta e publikut për t'ju drejtuar gjykatës për çështje të mjedisit has dy lloj barrierash: ligjore dhe financiare.

Barriera ligjore: Reforma e vitit 2012 që rezultoi në krijimin e Gjykatës Administrative me anë të Ligjit Nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjyktave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”* u konsiderua gjatë takimit të grupit të punës si e dobishme për sa i përket aksesit në drejtësi për çështjet mjedisore. Në fakt me hyrjen në fuqi të këtij ligji subjektet por edhe OJF-të kanë një akses më të gjerë pranë gjykatës administrative. Megjithatë pengesat ligjore ekzistojnë sidomos për sa i përket çështjes së legjitimitetit të subjekteve për t'ju drejtuar gjykatës me anë të një kërkesë padie. Ndërsa çështja e legjitimitetit të individëve është më e qartë dhe lë pak vend për interpretim, përderisa neni 15 (a) i Ligjit Nr. 49/2012 parashikon se legjitimohet t'i drejtohet gjykatës administrative *“çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga*

*një veprim apo mosveprim i organit publik”, më e komplikuar mbetet çështja e legjitimitetit të OJF-ve dhe grupeve të interesit që trajtojnë çështjet mjedisore. Për këto të fundit parashikohet nga neni 15 (d) i Ligjit Nr. 49/2012 legjitimimi në rastet kur pretendojnë “se është cenuar një interes i ligjshëm publik: (i) nga një akt normativ; (ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj”. Si rrjedhojë legjitimimi i shoqatave dhe grupeve të interesit është i kufizuar nga legjislacioni shqiptar pasi një shoqatë apo organizatë mund të ankohet në gjykatë vetëm për të **shfuqizuar një ligj apo akt që cënon interesin publik**, por nuk mund të kërkojë realizimin apo zbatimin e një reforme apo projekti të ri ligjor që do të përmirësonte situatën.*

Për më tepër praktika gjyqësore në lidhje me çështjet mjedisore është pothuajse jo-ekzistuese në Shqipëri. Megjithë problemet madhore të gjendjes së mjedisit në Shqipëri, as individët dhe as OJF-të nuk e kanë zakon të ndjekin rrugët gjyqësore për zgjidhjen e çështjeve me impakt mjedisor. Arsyet e kësaj mangësie janë të shumta dhe të ndërthurura, duke nisur nga situata socio-ekonomike e individëve, nga barrierat financiare që do të shpjegohen më poshtë, nga mosbesimi i përhapur në ndërgjegjen shqiptare ndaj organeve gjyqësore apo edhe për shkak të mungesës së një edukate të mbrojtjes së mjedisit në vetë shoqërinë shqiptare. **Mungesa e njohjeve dhe dijeve mbi çështjet ligjore** të mjedisit, nga publiku por edhe nga vetë punonjësit e gjykatave e vështirëson këtë proces. Përveç kësaj Gjykata Administrative, e cila siç u përmend më sipër sjell disa risi dhe lehtësira për legjitimimin e publikut, ka vetëm pak kohë që është krijuar gjë që ka bërë akoma të pamundur shfrytëzimin optimal të potencialeve që ajo ofron.

Barriera Financiare: Pavarësisht barrierave ligjore, aksesit në drejtësi ndikohet në mënyrë domethënëse nga barrierat financiare. Siç u vu në dukje gjatë takimit të grupit të punës barrierat financiare konsistojnë jo vetëm në taksën e padisë që secili paditës është i detyruar të para paguaj në momentin e ngritjes së padisë, por veçanërisht në shpenzimet e nevojshme për konsulencën ligjore apo konsulencën teknike të çështjeve mjedisore. Duke mbajtur parasysh se një pjesë domethënëse e qytetarëve shqiptar jetojnë në kushte të vështira financiare, barriera financiare për individët që dëshirojnë të adresojnë gjykatat në lidhje me çështjet mjedisore, është e lartë, shpesh e papërbalueshme. Edhe vetë OJF-të apo grupet e tjera të interesit të shoqërisë civile që trajtojnë çështjet mjedisore nuk kanë burimet e duhura njerëzore dhe financiare për t’iu drejtuar gjykatës me pretendime për çështje mjedisore. Pra në faktori financiar është pengesë në të drejtën e aksesit në gjykatë në Shqipëri.

❖ **Rekomandime**

Do të ishte e dobishme që Neni 15 (d) i Ligjit Nr. 49/2012 të ndryshohej dhe të zgjeronte fushën e zbatimit duke parashikur legjitimimin e shoqatave dhe grupeve të interesit t’i

drejtohen gjykatës edhe për rastes kur interesi i ligjshëm publik çënohet nga një veprim apo mosveprim i administratës publike, njësoj si në rastin e individëve.

Në situatën aktuale ligjore është e këshillueshme që OJF-të, grupet e interesit dhe shoqëria civile por edhe autoritetet publike si p.sh Avokati i Popullit të nxisin individët të cilët kanë legjitimim më të gjerë dhe të bashkëpunojnë ngushtësisht me ta, për të adresuar pranë gjykatave çështjet që lidhen me mjedisin. Në këtë mënyrë do të krijohet ekspertizë në çështjet ligjore mjedisore nga individët, shoqatat, shoqëria civile por edhe vetë gjyqtarët, duke sjellë si rrjedhojë futjen e frymës së mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet zbatimit të ligjit në shoqërinë shqiptare. Ndihet nevoja e kryerjes së trajnimeve të vazhdueshme për sensibilizim dhe informim e gjyqtarëve mbi çështjet ligjore mjedisore. Gjatë takimit të grupit të punës u përmenden si trajnime të suksesshme ato të kryera në këtë kuadër nga REC Albania me studentët e shkollës së Magjistraturës.

Për sa i përket barrierave financiare këshillohet që individët të cilët dëshirojnë të ndjekin çështjet mjedisore pranë gjykatave por nuk kanë mjetet e nevojshme financiare, të shfrytëzojnë hapsirat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar për ndihmën ligjore dhe nga shoqatat të cilat ofrojnë shërbime ligjore falas. U këshillua shprehimisht se një bashkëpunim midis OJF-ve që trajtojnë çështje mjedisore me OJF-të që ofrojnë shërbime ligjore falas mund të ishte i frytshëm për ndjekjen në rrugë gjyqësore të çështjeve të ndjeshme mjedisore. Edhe vetë autoritetet shtetërore, në përmbushje të parimeve dhe detyrimeve të parashikuara në Konventën e Aarhus-it duhet të aktivizohen brenda kufijve të kapacitetit të tyre për të mundësuar ofrimin e shërbimeve ligjore falas për çështje me impakt të lartë mjedisor.

Pjesëmarrës në Sesionin I, Grupin e Punës: Institucione shtetërore dhe shoqëri civile

Institucione shtetërore :

Ministria e Mjedisit

Drejtorja e Mjedisit - Redi Baduni

Drejtorja e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura-Polikron Horeshka, Ermal Halimi

Spektori i Programimit dhe Koordinimit Ndërinstitucional- Sabina Cenameri

Agjencia Kombëtare e Mjedisit- Etleva Sinoimeri, Enkeleda Shkurta



Shoqëri Civile :

Ekspertë të Grupeve të Punës: Holta Ymeri

Ekspert jurist: Vangjel Kosta, anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC): Mihallaq Qirjo

Qendra EDEN: Ermelinda Mahmutaj , Lira Hakani

Ekolëvizja: Alisa Peçi

Qendra ALBAFOREST: Genci Haxhiu

Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri(PPNEA): Elkonis Buhaljoti

Instituti per Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit(ETMI): Inklida Allka

Media, East Journal: Lavdim Lita

Universiteti i Tiranës: Jona Karapinjalli